

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® MultiSeal

SHIRIT BITUMINOZ PËR IZOLIM

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® MultiSeal është shirit izolimi bituminoz, i vetëngjithshëm, i modifikuar me gomë dhe me fletë alumini në anën e sipërme.

PËRDORIMET

Sika® MultiSeal është krijuar për aplikime izolimi dhe riparimi kundër hyrjes së ujit në çati dhe në elemente të tjera të ndërtesës.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Aplikim shumë i lehtë
- Ndërkapje e mirë mbi shumë nënshtresa
- I vetëngjithshëm
- Kompatibël me nënshtresat bituminoze
- Mund të lyhet
- Mund të aplikohet në temperatura të ulëta

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Shirit bituminoz i modifikuar me gomë		
Ambalazhi	Gjatësi/ rulon (m)	Gjerësi shiriti (mm)	Rulona/ kuti
	3	100	12
	3	200	6
	3	225	6
	10	50	6
	10	75	4
	10	100	3
	10	150	2
	10	200	3
	10	225	2
	10	300	1
	10	450	1
	10	600	1
Paraqitja / Ngjyra	gri mat, kafe terrakota		
Jetëgjatësia	Sika® MultiSeal ka jetëgjatësi prej 36 muajsh nga data e prodhimit, nëse ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur dhe nëse plotësohen kushtet e magazinimit.		
Kushtet e magazinimit	Sika® MultiSeal duhet të ruhet në kushte të thata, i mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe në temperatura midis +5°C dhe +25°C.		
Trashësia	~1,2 mm		

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj tërheqjes	~3,6 N/mm ²	
Zgjatimi deri në thyerje	~50 %	
Reagimi ndaj zjarrit	B2	(DIN 4102)
Temperatura e funksionimit	-20 °C min. / +70 °C max.	

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +40 °C max.
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +40 °C max., min. 3 °C mbi temperaturën e pikës së vesës Në temperatura nën +10 °C shiriti dhe nënshtresa duhet të ngrohen me ventilues ajri të nxehtë përpara dhe gjatë aplikimit.

UDHËZIME APLIKIMI

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e pastër, e thatë, e qëndrueshme dhe homogjene, pa vaj, graso, pluhur dhe grimca apo materiale të lira.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Prisni shiritin në gjatësinë e kërkuar, tërhiqni fletën dhe ngjeshni shiritin fort mbi nënshtresë me një rul të përshtatshëm.
Mbivendosjet duhet të jenë min. 5 cm.
Performanca e ndërkapjes mund të përmirësohet duke ngrohur shiritin Sika® MultiSeal gjatë aplikimit.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit me Sika® Remover-208. Pas tharjes, materiali i mbetur mund të hiqet vetëm mekanikisht. Për pastrimin e lëkurës përdorni Sika® Cleaning Wipes-100.

KUFIZIME

- Ana e sipërme e Sika® MultiSeal mund të lyhet me shumicën e sistemeve konvencionale të bojës.
- Mos përdorni Sika® MultiSeal mbi gurin natyror.
- Mos përdorni Sika® MultiSeal për fugat nën presion uji apo me prani të përhershme nën ujë.
- Duhet shmangur kontakti i drejtpërdrejtë me izoluesit dhe adezivët ose duhet të testohet kompatibiliteti përpara aplikimit.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® MultiSeal

Shkurt 2019, Botimi 02.01

020516050000000009

SikaMultiSeal-sq-AL-(02-2019)-2-1.pdf